



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

STREET LAW INC



AKADEMIA PËR UDHËHEQËSI NË KOMUNITET – EDICIONI NË PEJË

THIRRJE PËR TË GJITHË TË RINJTË DHE TË REJAT E MOSHËS 18-24 VJEÇ

Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) fton 18-24 vjeçarët/et nga Peja, Klina dhe Istogu të bëhen pjesë e edicionit të dytë të Akademisë për Udhëheqësi në Komunitet, e cila zhvillohet në kuadër të Programit për Angazhim Qytetar, një iniciativë pesë vjeçare që zbatohet në partneritet me misionin e USAID në Kosovë.

Programi i Akademisë, i cili ofrohet falas, është hartuar në bashkëpunim me Street Law, organizatë prestigjioze në fushën e edukimit jo-formal me bazë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. I njëjti, është përvojë unike që ofron trajnim dhe përgatitje profesionale, përmes dy punëtorive të planifikuara në fillim dhe fund të programit, krahas takimeve dhe punës praktike të vazhdueshme, në organizim dhe zbatim të nismave në komunitet. Zhvillohet nga trajnerë me njohuri dhe përvojë të dëshmuar që do t'ju ndihmojnë të bëheni qytetarë aktivë dhe të përgjegjshëm, si dhe të ndërtoni rrjet me aktivistë e profesionistë tjerë në komunitetin dhe vendin ku jetoni.

ÇKA PËRFITONI NGA KJO AKADEMI?

Ju do të jeni më të përgatitur rreth:

1. Parimeve themelore të demokracisë, rolin e qytetarëve në ruajtjen dhe zhvillimin e demokracisë dhe zhvillimin demokratik në Kosovë, përfshirë dobësitë, sfidat dhe mundësitë;
2. Njohjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të garantuara me kushtetutë dhe konventat ndërkombëtare;
3. Identifikimit të problemeve dhe çështjeve kryesore që prekin lagjen e qytetit tuaj, apo grupin e komunitetit të cilit i përkisni apo përkrahni, si dhe gjetjen e mundësive për adresim të këtyre problemeve përmes angazhimit qytetar;

4. Udhëheqësisë dhe aktivizmit, përfshirë të menduarit kritik, komunikimin, zgjerimin e grupit të përkrahësve dhe komunitetit, si dhe aftësive hulumtuese;

5. Procesit të përpilimit të një nisme për të adresuar një çështje/nevojë në komunitetin tuaj;

SI DHE DO TË:

6. Keni besim të shtuar në aftësitë tuaja për të krijuar ndryshime pozitive shoqërore;

7. Zgjeroni rrjetet tuaja personale dhe profesionale me të tjerët që angazhohen për ndryshime pozitive në Kosovë;

8. Keni mundësi të angazhoheni aktivisht dhe të avokoni për çështje të rëndësishme të komunitetit dhe të ndikoni në politika dhe vendimmarrje.



JU PO ASHTU DO TË:

- Zhvilloni ide origjinale dhe konkuroni për një mini-grant për zbatimin e një nisme në komunitetin tuaj;
- Jeni pjesë e aktiviteteve të tjera të Programit për Angazhim Qytetar zbatuar nga KCSF dhe misioni i USAID në Kosovë;
- Shërbeni si pikë referuese dhe përkrahëse për aktivizëm e pjesëmarrje në jetën publike për anëtarët e komunitetit ku jetoni;
- Bëheni pjesë e një rrjeti të aktivistëve të rinj, i pari i këtij formati në Kosovë

KUSH MUND TË APLIKOJË DHE CILAT JANË KRITERET E APLIKIMIT?

Të drejtë aplikimi kanë 18-24 vjeçarët/et nga Peja, Istogu dhe Klina.

Kriteret e aplikimit:

- Të jeni të interesuar të zgjeroni njohuritë dhe aftësitë për t'u angazhuar për ndryshime pozitive në komunitetin tuaj / shkollë / organizata lokale.
- Të jeni të interesuar në pjesëmarrjen e të rinjëve / organizimin e shoqërisë civile / aktivizmin në komunitet.
- Të jeni të gatshëm dhe të motivuar për t'u bashkuar dhe përfunduar programin e Akademisë duke e vijuar rregullisht, si dhe për të përfituar nga angazhimet dhe mundësitë e tjera pas Akademisë.

KCSF inkurajon gjithëpërfshirje nga aspekti gjinor dhe i etnisë.



SI TË APLIKONI?

Klikoni dhe plotësoni formularin për aplikim në vegëzën <https://forms.office.com/r/k27B3g2vfB>, për tu bërë njëri nga 25 pjesëmarrësit që do të përzgjidhen për të filluar rrugëtimin 12 javor të të mësuarit dhe aktivizmit në komunitet.

Aplikimi është i hapur deri më 30 shtator 2023, në ora 23.59. Nxito dhe bëhu pjesë e programit tonë!

Nëse pranoheni dhe përkushtoheni që të përfundoni programin e Akademisë (shtator – dhjetor 2023), do të merrni përkrahjen dhe përgatitjen më të mirë të mundur për të organizuar komunitetet tuaja dhe të sillni ndryshime me përkrahje të Programit për Angazhim Qytetar.

RRETH PROGRAMIT PËR ANGAZHIM QYTETAR:

Qëllimi kryesor i Programit për Angazhim Qytetar është të ushqejë kulturën e aktivizmit që e bën jetën në lagjet dhe qytetet tona më të mirë, më të kujdesshme dhe më kuptimplotë. Nëpërmjet aktiviteteve të tij, programi do të realizojë një numër të veprimeve të bazuara në tre shtylla thelbësore: angazhimin e komunitetit, rritjen e besimit ndër-shoqëror si dhe zgjerimin e mobilizimit e burimeve të reja.

Na kontaktoni:

Nëse ju duhen më shumë informata, ju lutem na kontaktoni në adresën elektronike aplikimi@kcsfoundation.org, apo në rrjetet tona sociale në:



<https://www.facebook.com/KCSFoundation>



https://www.instagram.com/kcsf_foundation/



<https://www.linkedin.com/company/kosovar-civil-society-foundation-kcsf-/>